



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Grupi Parlamentar i Partisë “Lëvizja Socialiste për Integrim”

Nr. 3883 Prot.

Tiranë, më 12.12 2018

Lënda : Kërkesë për ndryshimin e rendit të ditës së seancës plenare të datës 13 dhjetor 2018.

KRYETARIT TË KUVENDIT

KËTU

I nderuar Zoti Kryetar,

Në kushtet e një greve të studentëve të universiteteve të të gjithë Shqipërisë, me qëllim dhënien e një zgjidhjeje të shpejtë dhe të drejtë të kërkesave të paraqitura prej tyre, deputetë të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Socialiste kanë depozituar dy nisma ligjvënëse: Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin “Për buxhetin e vitit 2019” dhe projektligjin “për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Bazuar në nenin 31 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë “Lëvizja Socialiste për Integrim”, po ju paraqes kërkesën për ndryshimin e rendit të ditës së seancës plenare të datës 13 dhjetor 2018 dhe shqyrtimin e këtyre projektligjeve, brenda kësaj date.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.

KRYETARI

Petrit VASILI